

L I G J
Nr.8234, datë 27.8.1997

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7561, DATË 29.4.1992 "PËR DISA NDRYSHIME E
PLOTESIME NË LIGJIN NR.7491, DATË 29.4.1991 "PËR DISPOZITAT KRYESORE
KUSHTETUESE"**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Presidentit të Republikës

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryesohet nga Presidenti I Republikës dhe përbëhet nga kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe nga 9 juristë të njohur për aftësitë e tyre. Ata zgjidhen njëherë në pesë vjet, sipas mënyrës së caktuar në ligj, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme, si më poshtë:

- Tre anëtarë zgjidhen nga radhët e gjykatësve,
- dy anëtarë zgjidhen nga radhët e prokurorëve,
- katër anëtarë zgjidhen nga Kuvendi Popullor, nga të cilët, dy prej radhëve të avokatëve, një prej profesoratit të drejtësisë dhe një prej radhëve të gjykatësve.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit, si dhe të prokurorëve.

Mënyra e funksionimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë përcaktohet në rregulloren e miratuar prej tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij nga Presidenti I Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1880, datë 27.8.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani